

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Drejtësisë
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Jo e zbatueshme
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	Data/Asnjë konsultim publik.
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	04/07/2023
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po 04/06/2023
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Viti 2023 – MD – Nr. VN
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Roland Stafa Roland.Stafa@drejtesia.gov.al +355676466807
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 10 rreshta)</i> Natyra e problemit ka karakter legjislativ që lidhet me vakuumin ligjor mbi caktimin dhe përlllogaritjen e pagës së magjistratit. Shkaku i këtij problemi është shfuqizimi i shkronjës “a”, të pikës 5, të nenit 12, të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me vendimin nr.35/2022, të Gjykatës Kushtetuese. Ky problem lidhet ngushtë edhe me pasigurinë e krijuar për shkak se paga duhet të paguhet sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe nevojës për të përballuar pagesën përmes parashikimeve të nevojshme buxhetore. Ndërhyrja e qeverisë në këtë moment është e nevojshme për shkak se pas shfuqizimit të dispozitës që parashikon edhe elementin bazë të pagës së magjistratit, në zbatim të vendimit nr.35/2022 të GJK nevojitet plotësimi i kuadrit ligjor mbi këtë element. Pa ndërhyrjen e qeverisë nuk mund të zgjidhet problemi në kushtet kur elementet e pagës së magjistratit janë përcaktuar në ligj dhe nevojitet parashikimi i saktë i pagës referuese bazë.	
OBJEKTIVAT <i>Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)</i> <i>Objektivat kryesorë që synohen të arrihen nëpërmjet miratimit të kësaj politike janë:</i>	

- Plotësimi i vakuimit ligjor të krijuar nga shfuqizimi i shkronjës “a”, të pikës 5, të nenit 12, të ligjit nr.96/2016, brenda vitit 2023;
- Sigurimi i zbatimit efektiv të vendimit nr.35/2022 të Gjykatës Kushtetuese, duke parashikuar një dispozitë të re mbi pagën referuese bazë të magjistratit;
- Sigurimi i nje planifikimi efektiv të shpenzimeve buxhetore për përbalimin e pagesave për pagën e magjistratit brenda vitit 2023.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsioni 0 – Status quo-ja sjell koston e pasjes së një vakuumi ligjor mbi pagën referuese bazë të magjistratit, mosadresimin e problemit dhe nuk sjell përfitime.

Opsioni 1 – Ndryshimi i ligjit nr.96/2016 mundëson adresimin e problemit dhe përmbushjen e objektivave dhe kostot lidhen vetëm me efektin financiar që do të sjellë dispozita e re mbi pagën referuese bazë.

Opsioni 2 – Miratimi i një ligji të ri mundëson adresimin e problemit dhe përmbushjen e objektivave, por është mjet i panevojshëm dhe sjell kosto më të larta, pavarësisht se përfitimet do të jenë të njëjta me atë të opsionit 2.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasiore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura. (jo më shumë se 10 rreshta)

Ndikimi monetar lidhet vetëm me efektin financiar në buxhetin e shtetit prej 959 milionë lekësh për pagën e magjistratëve, si dhe funksionarëve të tjerë të lartë shtetërorë dhe nëpunësve të tjerë, paga e të cilave përllogaritet në bazë të pagës së magjistratit. Ndikimet e përbashkëta për çdo grup të prekur janë shmangia e vakuimit ligjor, zbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe qartësi në parashikimin buxhetor të shpenzimeve për pagën e subjekteve të sipërcituara, ndërsa për magjistratët, funksionarët e lartë shtetërorë, si dhe nëpunësit e tjerë brenda sistemit të drejtësisë ndikimet e drejtpërdrejta janë rritja e pagës së magjistratëve dhe nëpunësve të tjerë brenda sistemit të drejtësisë, paga e të cilëve përllogaritet në bazë të pagës së magjistratëve. Ndërkohë, ndikimet jo të drejtpërdrejta janë rritja e përfitimeve që rrjedhin nga rritja e pagës, rritja e mbrojtjes që ofron rritja e pagës ndaj tendecave të korrupsionit, si dhe rritja e e standardit të jetesës.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsioni i zgjedhur është opsioni nr.1, pasi është i vetmi opsion nëpërmjet të cilit adresohet problemi dhe arrihen objektivat. Edhe nga pikëpamja e teknikës legjislative është opsioni i preferuar për shkak se nuk parashikohet të kryhen ndryshime që prekin më shumë 50% të dispozitave të ligjit. Ndryshimi i ligjit është mjet i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm, pasi problematikat e evidentuara mund të adresohen më së miri me ndryshimin e dispozitave në fuqi. Edhe sipas analizave të kryera rezulton se ai është opsioni më i përshtatshëm dhe me më pak kosto. Problemi ka karakter legjislativ dhe çdo opsion me karakter jorregullator nuk i shërben qëllimit dhe arritjes së objektivave.

Kostoja e përllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
48.9	48.9	48.9

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta)

Projektligji i është përcjellë për mendim Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë përmes sistemit e-akte, e cila po përmes këtij sistemi ka shprehur dakordësinë.

Gjithashtu, projektakti i është përcjellë për mendim Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe Prokurorisë së Përgjithshme me shkresën me nr.2056/1 prot., datë 30.3.2023.

Në vijim, projektligji u kthye nga ana e KM për marrjen e mendimeve të KLGJ, KLP dhe PP.

Me shkresën nr.506/1 prot., datë 5.4.2023, Prokuroria e Përgjithshme është shprehur se në parim janë dakord me propozimin e projektligjit nëse në tërësi nuk bie ndesh me vendimin nr.35/2022 të Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë nga studimi i projektligjit dhe ligjeve të tjera të lidhura me të, konstatojmë se në ligjet periodike për buxhetin e shtetit nuk është cilësuar që paga e Presidentit indeksohet një herë në dy vjet, ashtu siç është përcaktuar në ligjin “Për përcaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”.

Gjithashtu, në këtë projektligj nuk shikojmë të reflektuar efektin financiar në lidhje me diferencën e pagës së magjistratëve, për periudhën kohore nga 1.1.2019 deri datën 9.1.2023, sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Për këtë arsye vlerësojmë se ndryshimet ligjore që propozohen nuk janë të plota pa marrë në konsideratë edhe çështjet e trajtuara më sipër.

Në lidhje me komentin e Prokurorisë së Përgjithshme mbi indeksimin e pagës, komenti është reflektuar, duke shtuar fjalinë: *“Paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë indeksohet me vendim të Këshillit të Ministrave, jo më vonë se dy vite nga indeksimi i fundit, në bazë të ndryshimit të indeksit të çmimeve të konsumit të vitit apo viteve paraardhëse të përlogaritur nga INSTAT.”*

Sa i përket efekteve financiare për periudhën kohore nga 1.1.2019 deri datën 9.1.2023, sillet në vëmendje se në pikën 2, të nenit 26, të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, është parashikuar se: *“2. Vendimet, si rregull, hyjnë në fuqi ditën e publikimit, përveçse kur është parashikuar ndryshe në këtë ligj. Kur vendimi sjell pasoja për të drejtat kushtetuese të individit, Gjykata Kushtetuese mund të vendosë që ai të hyjë në fuqi ditën e shpalljes së tij. Në këtë rast, vendimi shoqërohet me një arsyetim të përmbledhur, ndërsa vendimi i arsyetuar plotësisht publikohet brenda 30 ditëve.”*

Në pikën 3, të po të njëjtit nen, parashikohet se: *“3. Gjykata Kushtetuese mund të urdhërojë që vendimi i saj, me të cilin ka shqyrtuar aktin, të fillojë efektet në një datë tjetër. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese mund të urdhërojë pezullimin e zbatimit të aktit të shfuqizuar prej saj ndaj kërkuesit në çështjen gjyqësore deri në kohën kur vendimi fillon efektet.”*

Ndërkohë në pikat 2, 3 dhe 4, të nenit 76, parashikohet se: *“2. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese që ka shfuqizuar një ligj apo akt normativ si të papajtueshëm me Kushtetutën ose me marrëveshjet*

ndërkombëtare, si rregull sjell efekte juridike nga data e hyrjes së tij në fuqi, përveç rasteve të parashikuara ndryshe nga ky ligj.

3. Gjykata Kushtetuese, në çdo rast, shprehet edhe për efektet e vendimit të saj.

4. Gjykata Kushtetuese mund të vendosë që vendimi për shfuqizimin e një akti të prodhojë pasoja në një datë tjetër, të ndryshme nga hyrja e tij në fuqi. Në këtë rast Kuvendi apo çdo institucion tjetër bën ndryshimet e nevojshme brenda afatit të përcaktuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe në përputhje me pjesën arsyetuese të tij.”

Ndërsa në pikën 7 të tij parashikohet se:

“7. Vendimi ka fuqi prapavepruese vetëm:

a) ndaj një dënimi penal edhe gjatë kohës që është në ekzekutim, nëse ai lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e ligjit ose të aktit normativ të shfuqizuar;

b) ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk janë përfundimtare dhe të formës së prerë;

c) ndaj pasojave ende të pazeauruara të ligjit apo aktit normativ të shfuqizuar”

Referuar dispozitave të sipërcituara, në vendimin nr.35/2022, Gjykata Kushtetuese nuk ka përcaktuar asnjë datë të ndryshme mbi fillimin e efekteve të vendimit të saj dhe as për fuqinë prapavepruese të tij.

Përkundrazi, në paragrafin nr.103 të vendimit nr.35/2022, Gjykata Kushtetuese është shprehur se:

“Në lidhje me efektet e këtij vendimi, Gjykata, duke theksuar rëndësinë e garancive dhe të parimeve kushtetuese me të cilat bien ndesh dispozitat e kundërshtuara, si dhe duke vënë në balancë interesat e mbrojtura kushtetutshmërisht, vlerëson se, në përputhje me pikën 2, të nenit 132, të Kushtetutës, dhe nenin 76, pikat 1, 2 dhe 3, të ligjit nr.8577/2000, ky vendim hyn në fuqi ditën e publikimit në Fletoren zyrtare.”

Për sa kohë Gjykata Kushtetuese është shprehur se efektet e vendimit fillojnë nga momenti i hyrjes në fuqi të tij, edhe përlllogaritja e efekteve financiare të projektligjit në lidhje me diferencën e pagës së magjistratëve është kryer vetëm për efektet financiare që fillojnë nga data 9.1.2023.

Pas shtimit të dispozitës mbi indeksimin e pagave në reflektim të komentit të Prokurorisë së Përgjithshme, projektligji i është dërguar edhe një herë për mendim MFE nëpërmjet sistemit e-aktet. Në vijim MFE ka shprehur përsëri dakordësinë nëpërmjet sistemit e-aktet.

Deri në datën e dërgimit të projektvendimit “Për propozimin e projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli i Ministrave, Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk ka përcjellë mendim.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përcjellë mendimin e tij me shkresën nr.2111/2 prot., datë 6.4.2023, ku pasi ka shprehur dakordësinë mbi projektligjin përderisa propozimi është konform nivelit të përcaktuar nga vendimi nr.35/2022 i GJK.

Më tej, ka kërkuar që në projektligj të parashikohet detyrimi për indeksimin e pagës së magjistratit sa herë dhe në të njëjtën mënyrë që indeksohet paga për punonjësit e tjerë të administratës shtetërore. Ky sugjerim është reflektuar dhe sqarimet e nevojshme janë dhënë më sipër.

KLJGJ është shprehur se projektligji nuk i jep zgjidhje situatës dhe problematikave të konstatuara nga Gjykata Kushtetuese në lidhje me pagat e magjistratëve nga 1.1.2019 deri në 9.1.2023, prandaj me qëllim shmangien e proceseve gjyqësore të cilat sjellin shpenzime të konsiderueshme për buxhetin e KLJGJ, kjo situatë duhet zgjidhur me një dispozitë tranzitore.

Sa i përket këtij komenti, vlejné të njëjtat argumente të dhëna më sipër për Prokurorinë e Përgjithshme.

Deri në datën e dërgimit të projektligjit pranë Këshillit të Ministrave, Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk ka përcjellë mendim.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?(jo më shumë se 5 rreshta)

MD do të përgjigjet për hartimin dhe dërgimin për miratim nga KM të propozimit për dërgimin e projektligjit për shqyrtim e miratim nga Kuvendi. Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokuroria e Përgjithshme, të gjithë institucionet e sistemit të drejtësisë si dhe të gjitha institucionet e tjera, të cilat paguajnë pagat e funksionarëve të lartë shtetërorë duke u bazuar në pagën e magjistratit, do të zbatojnë dispozitat e reja të ligjit. Hapat kryesorë për zbatimin e opsionit janë hartimi i dispozitave, hartimi i akteve nënligjore në zbatim të tij nëse do të parashikohen të tilla, verifikimi i nevojave për të ndërhyrë në akte të tjera nënligjore të cilat mund të mos jenë në përputhje me parashikimet e projektligjit. Monitorimi do të kryhet së pari nga vetë institucionet që ngarkohen me zbatimin e tij, si dhe nga të gjithë organizmat që ushtrojnë kontroll mbi institucionet publike, si Kontrolli i Lartë i Shtetit, inspektimi financiar, si dhe auditit i brendshëm.

Vlerësimi i zbatimit të projektligjit dhe arritjes së objektivave do të kryhet përmes raporteve vjetore që institucionet i paraqesin Kuvendit. Treguesit për arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre janë shmangia e vakuimit ligjor, brenda vitit 2023, krahasimi i pagës referuese bazë që del nga zbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese në raport me pagën që rezulton nga dispozita e re ligjore, si dhe raportet e KLSH, auditit të brendshëm etj.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës.

Në vitin 2016 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi një sërë ligjesh me qëllim reformimin e sistemit të drejtësisë. Një nga këto ligji është edhe ligji nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” i cili krahas të tjerave rregullon në kreun III të tij edhe pagën dhe përfitimet e tjera financiare e shoqërore të magjistratëve.

Paga e magjistratit është parashikuar nga neni 12, ku përcaktohet se paga mujore bruto e magjistratit përbëhet nga paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë, shtesa për pagën në grup, shtesa për vjetërsi, e llogaritur mbi pagën referuese bazë, sipas pikave 3 dhe 4, të këtij neni, shtesa për pozicionin drejtues, shtesa për vështirësi pune, në masën 80 për qind të pagës bruto fillestare, për magjistratët që ushtrojnë funksionin pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykatës së Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Paga e magistratëve, sipas skemës së re të trajtimit financiar të përcaktuar në ligjin nr.96/2016, ka filluar të zbatohet pas datës 1.1.2019. Në përlllogaritjen e pagës mujore të magistratëve, elementi “pagës referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë ishte e njëjtë me “pagën për funksion” të punonjësve të shërbimit civil të kategorisë së parë, klasa e tretë në pozicionin e drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri ose me çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave”.

Në muajin tetor-nëntor të vitit 2020, Kontrolli i Lartë i Shtetit kreu një auditim tematik pranë KLGJ, në përfundim të të cilit ka dhënë rekomandimin: “Për të gjithë magistratët, paga referuese bazë të përlllogaritet mbi bazën e plotë të pagës së drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri, e cila përbëhet nga paga e grupit, plus shtesën e pagës (132 100 = 14 000 + 118 100) dhe jo vetëm mbi shtesën për pozicion (118 100). Paga duhet të bëhet duke filluar nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (ose emërimit për personat e punësuar pas kësaj date) dhe të përlllogaritet për të gjithë periudhën, bashkë me të gjitha shtesat dhe pakësimet.”.

Në datën 23.3.2021, Kuvendi miratoi ligjin nr.50/2021, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” (ligji nr.50/2021), përmes së cilit u ndryshua neni 12, pika 5, shkronja “a”, e ligjit nr.96/2016, me këtë përmbajtje: *“a) paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë, e cila është e njëjtë me vlerën e elementit “shtesa për pozicion” të pagës mujore të pozicionit drejtor i drejtorisë së përgjithshme apo të çdo pozicioni tjetër të barasvlershëm me të në Kryeministri. “Shtesa për pozicion” është elementi bazë i pagës mujore të nëpunësve civilë, nëpërmjet së cilës caktohet vlera e çdo vendi pune në shërbimin civil, pa u diktuar nga ndryshimet e pagës që shkaktohen nga rrethanat e posaçme ose individuale të vetë nëpunësit civil si vjetërsia apo shtesa për kushte pune. Për qëllimet e caktimit të pagës referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë, “shtesa për pozicion” është i njëjti element i pagës si edhe elementi “paga bazë e kategorisë”, sipas përcaktimeve të ligjit për nëpunësin civil, apo me çdo lloj emërtimi tjetër që cakton elementin bazë të pagës mujore të pozicionit drejtor i drejtorisë së përgjithshme apo të çdo pozicioni tjetër të barasvlershëm me të në Kryeministri. Referimi i pagës mujore bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë me vlerën e elementit “shtesa për pozicion” ose “paga bazë e kategorisë” sipas përcaktimeve të mësipërme nuk ka si qëllim të përcaktojë vlerën relative të funksioneve gjyqësore dhe të prokurorisë me pozicionet e punës në shërbimin civil ose të mundësojë klasifikimin e tij në kategorinë ose klasën përkatëse.”.*

Në 2022, Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë (Unioni) i është drejtuar Gjykatës për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën, ndër të tjera, edhe të nenit 12, pika 5, shkronja “a”, të ligjit nr.96/2016, të ndryshuar me ligjin nr.50/2021, duke arsyetuar cenimin e paprekshmërisë së pagës së magistratit të garantuar nga neni 138 të Kushtetutës nga kjo dispozitë.

Me vendimin nr.35/2022¹, Gjykata Kushtetuese vendosi pranimin e kërkesës dhe shfuqizimin e nenit 12, pika 5, shkronja “a”, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me nenin 2, pika 1, të ligjit nr.50/2021, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

¹ https://ëëë.gjk.gov.al/ëëb/Vendime_perfundimtare_100_1.php

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Natyrë e problemit ka karakter legjislativ që lidhet me vakuumin ligjor mbi caktimin dhe përlllogaritjen e pagës së magjistratit. Shkaku i këtij problemi është shfuqizimi i shkronjës “a”, të pikës 5, të nenit 12, të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me vendimin nr.35/2022 të Gjykatës Kushtetuese.

Ky problem lidhet ngushtë edhe me pasigurinë e krijuar për shkak se paga duhet të paguhet sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe nevojës për të përballuar pagesën përmes parashikimeve të nevojshme buxhetore.

Ky problem shtrihet në të gjithë sistemin e drejtësisë, si dhe prek magjistratët dhe të gjithë ata funksionarë shtetërorë dhe nëpunës të cilëve paga iu llogaritet në bazë të pagës së magjistratit për shkak të shfuqizimit të dispozitës që rregullon një nga elementet e pagës së magjistratit.

Grupet e prekura nga ky problem janë:

Institucionet e sistemit të drejtësisë – Vakuumi ligjor prek drejtpërdrejt veprimtarinë dhe ushtrimin e kompetencave nga ana e institucioneve të sistemit të drejtësisë mbi shpërblimin e punës së magjistratëve dhe funksionarëve apo nëpunësve të tyre, paga e të cilëve llogaritet duke u bazuar në pagën e magjistratit.

Qeveria dhe autoritetet publike – Avokati i Popullit, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, anëtarët e Komisionit të Prokurimit Publik, etj., marrin pagë në bazë të pagës së magjistratit dhe gjenden në të njëjtën situatë si institucionet e sistemit të drejtësisë.

Qeveria preket nga ky problem edhe për shkak se ka marrë angazhimin për krijimin e një sistemi drejtësie të pavarur dhe të besueshëm, i cili shmang korrupsionin. Një ndër elementet për arritjen e një sistemi të tillë drejtësie është përcaktimi i një page të përshtatshme e cila nga njëra anë i përgjigjet dinjitetit të profesionit dhe, nga ana tjetër, e mbron shmang korrupsionin në radhët e sistemit. Ndërkohë, një efekt i drejtpërdrejtë i këtij problemi evidentohet në buxhetin e shtetit për shkak të nevojës për përlllogaritjen e shpenzimeve të cilat shërbejnë për të mbuluar shpenzimet për pagat e magjistratëve dhe të gjithë atyre funksionarëve apo nëpunësve të cilët paguhen në bazë të pagës që merr magjistrati.

Magjistratët dhe të gjithë ata funksionarë shtetërorë dhe nëpunës të cilëve paga iu llogaritet në bazë të pagës së magjistratit preken për shkak të shfuqizimit të dispozitës që përcakton elementin bazë të pagës së tyre. Disa nga institucionet, në bazë të buxhetit në dispozicion, e kanë zbatuar drejtpërdrejt vendimin e Gjykatës Kushtetuese, por pjesa tjetër, e cila nuk e ka përlllogaritur këtë shpenzim, do të përballlet me pasigurinë për marrjen e pagës në përputhje me këtë vendim.

Qytetarët, media dhe organizatat e shoqërisë civile, komuniteti i biznesit – nuk preken nga ky problem sepse dhënia e drejtësisë dhe shërbimit nga ana e institucioneve nuk ndikohet nga ky problem.

Problemi i mësipërm mund të trajtohet vetëm përmes ndryshimit të politikës pasi përbën dështim rregullator dhe si i tillë nuk mund të adresohet nga aktorë apo institucione të tjera. Natyra e problematikës është e tillë që dikton nevojën për ndryshime politike dhe vetëm ky instrument mund të garantojë trajtimin e problemit.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Ndërhyrja e qeverisë në këtë moment është e nevojshme për shkak se pas shfuqizimit të shkronjës “a”, të pikës 5, të nenit 12 të ligjit nr.96/2016, që përbën edhe elementin bazë të pagës së magjistratit, në zbatim të vendimit nr.35/2022 të GJK nevojitet plotësimi i kuadrit ligjor mbi këtë element. Pa ndërhyrjen e qeverisë nuk mund të zgjidhet problemi në kushtet kur elementet e pagës së magjistratit janë përcaktuar në ligj dhe nevojitet parashikimi i saktë i pagës referuese bazë.

Përmes ndërhyrjes qeveria synon të trajtojë problemin e vakuimit të shfaqur pas vendimit nr.35/2022 të Gjykatës Kushtetuese, duke siguruar në të njëjtën kohë edhe planifikimin e duhur buxhetor për shpenzimet për vijimin e pagesës së pagës së magjistratëve.

Kjo ndërhyrje mbështet një nga objektivat kryesorë të qeverisë i cili është reformimi i sistemit të drejtësisë dhe mbështetja e implemtimit të saj. Përmes ndërhyrjes garantohet paprekshmëria e pagës së magjistratit, si dhe krijimi i një sistemi drejtësie të pavarur dhe larg korrupsionit. Në dokumentet politike të hartuara gjatë procesit të reformës në drejtësi dhe gjatë zbatimit të saj, trajtimi financiar i magjistratit është evidentuar si një nga elementet kryesore të cilat garantojnë një sistem drejtësie të pavarur. Ndërhyrja e qeverisë mbështet angazhimet e marra nga qeveria për reformimin e sistemit të drejtësisë, duke përfshirë një trajtim të duhur financiar të magjistratit.

Puna e bërë deri më tani është analizimi i vendimit nr.35/2022 të Gjykatës Kushtetuese dhe efekteve që sjell si dhe vlerësimi i mënyrave të zbatimit të tij.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

- Plotësimi i vakuimit ligjor të krijuar nga shfuqizimi i shkronjës “a”, të pikës 5, të nenit 12, të ligjit nr.96/2016, brenda vitit 2023;

- Sigurimi i zbatimit efektiv të vendimit nr.35/2022 të Gjykatës Kushtetuese, duke parashikuar një dispozitë të re mbi pagën referuese bazë të magjistratit;

- Sigurimi i një planifikimi efektiv të shpenzimeve buxhetore për përballimin e pagesave për pagën e magjistratit brenda vitit 2023.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*

- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

Opsioni 0 – Status quo-ja ose mosndryshimi i gjendjes aktuale duke vijuar me kuadrin ligjor ekzistues;

Opsioni 1 – Ndryshimi i ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

Opsioni 2 – Miratimi i një ligji të ri.

Opsioni 0: Nuk ndërhyhet me ndryshim apo politikë të re dhe vijohet me kuadrin ligjor ekzistues e konkretisht me mungesën e një dispozite që rregullon pagën bazë referuese të magjistratit. Sipas këtij opsioni nuk ndërmerret asnjë masë për të shmangur vakuumin ligjor. Problemi nuk adresohet dhe grupet e prekura do të vijojnë të gjenden në të njëjtën situatë.

Opsioni 1: Ndryshimi i ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, është një nga opsionet e analizuara duke qenë se problemi ka karakter legjislativ. Sipas këtij opsioni problemi adresohet përmes ndërhyrjes në ligjin në fuqi. Ky është opsioni i preferuar dhe është një mjet i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm, pasi përmes tij arrihen objektivat dhe adresohet problemi që dikton nevojën për ndërhyrje dhe paraqet kosto më të ulët. Edhe nga pikëpamja e teknikës legjislative ky opsion është opsioni i preferuar për shkak se nuk parashikohet të kryhen ndryshime që prekin më shumë se 50% të dispozitave të ligjit duke qenë se synohet të ndryshohet vetëm një dispozitë e ligjit ekzistues.

Opsioni 2: Hartimi një ligji të ri për trajtimin financiar të magjistratëve për të adresuar problematikën dhe arritur objektivat. Sipas këtij opsioni do të hartohet dhe miratohet një ligji tërësisht i ri që shfuqizon dispozitat e ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, që lidhen me pagën e magjistratëve. Duke qenë se politika që do të ndërmerret synon të ndryshojë vetëm një dispozitë të ligjit ekzistues dhe duke qenë se ky ligj rregullon në mënyrë shteruese dhe efikase të gjitha çështjet e tjera, shihet si një opsion më pak i favorshëm krahasuar me opsionin 1. Gjithashtu, ky opsion nuk është opsioni i dëshiruar pasi rezultatet janë të njëjta me atë të opsionit 2, por kostot janë shumë më të larta.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni grupet e prekura.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasimore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*

- *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
- *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbliidhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuar.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuar krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).*

A. Grupet e prekura nga opsioni 1 janë qeveria, institucionet e sistemit të drejtësisë, magjistratët, si dhe funksionarët dhe nëpunësit e tjerë, paga e të cilëve llogaritet në bazë të pagës së magjistratëve.

Ndikimet e drejtpërdrejta në buxhetin e shtetit

Sipas Gjykatës Kushtetuese, vlera e pagës referuese bazë përcaktohet nga dy elemente, përkatësisht kategoria e pagës së sekretarit të përgjithshëm, që sipas interpretimit të Gjykatës Kushtetuese kjo kategori duhet të ishte I-b si dhe elementi i pagës për grup, që sipas VKM nr.187/2017, ishte 14 000 lekë. Po ashtu, sipas ndryshimeve që ka pësuar VKM nr.187/2017, nëpërmjet VKM nr.621, datë 28.9.2022, vlera e pagës për kategorinë I-b është 138 700 lek. Rrjedhimisht, si një e drejtë e fituar e magjistratëve, paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë nuk mund të jetë më e vogël se 152700 lekë.

Parashikohet që referenca e re të kryhet në pagën e Presidentit të Republikës. Në ndryshimet që do të bëhen në ligjin nr.9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, të ndryshuar, parashikohet që paga e Presidentit të Republikës do të jetë në masën 425 000 lekë në muaj. Në këto kushte, paga e magjistratit, do të jetë e barabartë me rezultatin që del nga shumëzimi i koeficientit 0.36 me pagën e re të Presidentit të Republikës në masën 425 000 lekë në muaj. Në këto kushte, paga e referuese do të jetë 153 000 lekë në muaj, e cila është më e lartë sesa paga prej 152 700 lekësh e llogaritur sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Sa më sipër, ndikimi i drejtpërdrejtë në buxhetin e shtetit është në masën 959 milionë lekë, për shkak të rrillogaritjes së pagës së magjistratëve dhe nevojës për të mbuluar shpenzimet për pagën e tyre, si dhe të funksionarëve të tjerë të lartë dhe nëpunësve, të paga e të cilëve llogaritet në bazët të pagës së magjistratit.

Qeveria:

Ndikimet e drejtpërdrejta për qeverinë janë:

1. Plotësohet vakuumi ligjor;
2. Zbatimi i vendimit nr.35/2022 të Gjykatës Kushtetuese;

Ndikimet jo të drejtpërdrejta janë:

1. Vijohet me mbështetjen e sistemit të drejtësisë dhe zbatimin e reformës në drejtësi;
2. Garantohet zbatimi i vendimit nr.35/2022 i Gjykatës Kushtetuese dhe paprekshmërisë së pagës së magjistratit.

Institucionet e sistemit të drejtësisë:

Ndikimet e drejtpërdrejta janë:

1. Përmbushja e detyrimit për të paguar magistratët dhe nëpunësit e tjerë në mënyrën e përcaktuar nga vendimi nr.35/2022 i Gjykatës Kushtetuese;
2. Efekte financiare në buxhetin e secilit institucion me qëllim kryerjen e pagesës së pagave të pagave të magistratëve dhe nëpunësve të tjerë të tyre.

Ndikimet jo të drejtpërdrejta janë:

1. Qartësia në parashikimin e nevojave për shpenzime buxhetore për përballimin e pagesave për pagën e magistratit;

Magjistratët, funksionarët e lartë shtetërorë, si dhe nëpunësit e tjerë brenda sistemit të drejtësisë

Ndikimet e drejtpërdrejta janë:

1. Rritja e pagës së magistratëve dhe nëpunësve të tjerë brenda sistemit të drejtësisë, paga e të cilëve përlllogaritet në bazë të pagës së magistratëve.

Ndikimet jo të drejtpërdrejta janë:

1. Rritje e përfitimeve financiare që rrjedhin nga rritja e pagës;
2. Rritje e mbrojtjes që ofron rritja e pagës ndaj tendecave të korrupsionit;
3. Rritje e standardit të jetesës.

Në mënyrë të përmbledhur, opsioni numër dy sjell si ndikim shmangien e vakuimit ligjor, zbatimin e vendimit nr.35/2022 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe një panoramë të qartë mbi nevojat buxhetore për shpenzimet për kryerjen e pagesës së pagave të subjekteve të prekura.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i zgjedhur është opsioni nr.1 që parashikon ndryshimin e ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Ky është parë si opsioni i preferuar, pasi nëpërmjet ndërhyrjes legislative do të bëhej i mundur adresimi i problematikës me qëllim parashikimin e një norme të qartë mbi pagën referuese bazë të magistratit.

Përmes këtij opsioni arrihen objektivat dhe adresohen problemet që diktojnë nevojën për ndërhyrje dhe paraqet kosto më të ulët. Edhe nga pikëpamja e teknikës legislative ky opsion është opsioni i preferuar për shkak se nuk parashikohet të kryhen ndryshime që prekin më shumë se 50% të dispozitave të ligjit. Ndryshimi është një mjet i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm për adresimin e problemit dhe arritjen e objektivave, pasi problemi mund të adresohet më së miri me ndryshimet në dispozitat e ligjit në fuqi dhe përfshirjes së dispozitave të reja nëse do të shihet e nevojshme. Duke qenë se ndërhyrja nuk lidhet me krijimin e një marrëdhënie të re juridike dhe as me rregullimin e një marrëdhënieje për të cilën nuk ka tashmë një kuadër rregullator, ky opsion vlerësohet si opsioni i preferuar. Gjithashtu, ky opsion paraqet kosto më të ulëta.

Ruajtja e *status quo*-s sjell si pasojë që të vijohet me vakuumin ligjor. Ky opsion nuk është i preferuar sepse nuk mund të adresojë problemin. Për këto arsye çdo masë me karakter jorregullator nuk i shërben qëllimit të ndërhyrjes dhe arritjes së objektivave.

Analiza e kosto – përfitimit (e pjesshme)

Grupet e prekura janë qeveria, institucionet e sistemit të drejtësisë, magjistratët, si dhe funksionarët e lartë shtetërorë si dhe nëpunësit e tjerë brenda sistemit të drejtësisë.

Sipas opsionit 0 nuk ka kosto të shtuara monetare për të gjitha grupet e prekura pasi nuk kryhet ndonjë ndërhyrje dhe situata mbetet siç është.

Sipas opsionit 1, kostoja përbëhet vetëm nga efektet financiare në buxhetin e shtetit. Sipas Gjykatës Kushtetuese, vlera e pagës referuese bazë përcaktohet nga dy elemente, përkatësisht kategoria e pagës së sekretarit të përgjithshëm, që sipas interpretimit të Gjykatës Kushtetuese kjo kategori duhet të ishte I-b si dhe elementi i pagës për grup, që sipas VKM nr.187/2017, ishte 14 000 lekë. Po ashtu, sipas ndryshimeve që ka pësuar VKM nr.187/2017, nëpërmjet VKM nr.621, datë 28.9.2022, vlera e pagës për kategorinë I-b është 138 700 lekë. Rrjedhimisht, si një e drejtë e fituar e magjistratëve, paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë nuk mund të jetë më e vogël se 152 700 lekë.

Parashikohet që referenca e re të kryhet në pagën e Presidentit të Republikës. Në ndryshimet që do të bëhen në ligjin nr.9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, të ndryshuar, parashikohet që paga e Presidentit të Republikës do të jetë në masën 425 000 lekë në muaj. Në këto kushte, paga e magjistratit, do të jetë e barabartë me rezultatin që del nga shumëzimi i koeficientit 0.36 me pagën e re të Presidentit të Republikës në masën 425 000 lekë në muaj. Në këto kushte, paga e referuese do të jetë 153 000 lekë në muaj, e cila është më e lartë sesa paga prej 152 700 lekësh e llogaritur sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Sa më sipër, ndikimi i drejtpërdrejtë në buxhetin e shtetit është në masën 959 milionë lekë, për shkak të rillogaritjes së pagës së magjistratëve dhe nevojës për të mbuluar shpenzimet për pagën e tyre, si dhe të funksionarëve të tjerë të lartë dhe nëpunësve, të paga e të cilëve llogaritet në bazët të pagës së magjistratit.

Sipas opsionit 2, përveç kostove të sipërcituara, evidentohen edhe kosto të tjera që lidhen me krijimin e grupeve të punës për hartimin e një projektligji tërësisht të ri, shpërblimin e ekspertëve, organizimin e tryezave të konsultimit, asistencën e partnerëve ndërkombëtarë etj. Ndërkohë, përfitimet do të jenë të njëjta me atë të opsionit 1.

Monetizimi i përfitimeve direkte dhe indirekte nga ndërhyrja është i pamundur të kryhet për shkak se nuk kemi të bëjmë me dhënien e një shërbimi i cili ofrohet kundrejt tarifës apo me ndërhyrje që ndikon drejtpërdrejt në ushtrimin e veprimtarive ekonomike.

Analiza e kosto – efektivitetit

Sipas analizës së kosto - efektivitetit opsionet nr.0 dhe nr.2 janë opsionet me më shumë kosto. Sipas opsionit 0 nuk ndërhyhet me ndryshim politike çka sjell si kosto mosplotësimin e vakuimit ligjor për pagën referuese bazë të magjistratit. Kjo kosto do të rëndojë mbi të gjitha grupet e prekura.

Opsioni nr.1 sjell koston më të ulët pasi përbëhet vetëm nga efektet financiare në buxhetin e shtetit mbi pagën e re të magjistratëve, si dhe të funksionarëve të lartë dhe nëpunësve të tjerë, paga e të cilëve përllogaritet në bazë të pagës së magjistratit. Njëkohësisht, ky opsion garanton përmbushjen e objektivave të analizuar më sipër.

Opsioni nr.2 është më i kushtueshëm se opsioni nr.1 për shkak se, përveç kostos së sipërcituar, kërkon buxhet shtesë për të hartuar një ligj tërësisht të ri që lidhen me shpërblimin e ekspertëve që do të hartojnë projektligjin, organizimin e tryezave të konsultimit, asistencën e partnerëve ndërkombëtarë etj.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e opsionit të preferuar janë:

- Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokuroria e Përgjithshme, si dhe të gjitha institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë të cilat paguajnë paga duke u bazuar në pagën e magjistratit;
- Të gjitha institucionet e tjera të cilat paguajnë pagat e funksionarëve të lartë shtetërorë duke u bazuar në pagën e magjistratit;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë në lidhje me efektet financiare të projektligjit;
- Ministria e Drejtësisë do të jetë përgjegjëse për koordinimin e procesit deri në miratimin nga Këshilli i Ministrave të propozimit për dërgimin e projektligjit për shqyrtim e miratim nga Kuvendi.

Pengesat për zbatimin e opsionit të preferuar mund të jenë vonesat në miratimin e projektligjit, si dhe mospërmbushja në mënyrën e duhur të detyrimeve që burojnë nga projektligji nga ana e institucioneve që ngarkohen me zbatimin e tij.

Masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për arritjen e qëllimeve të politikës janë: hartimi i dispozitave, hartimi i akteve nënligjore në zbatim të tij nëse do të parashikohen të tilla, verifikimi i nevojave për të ndërhyrë në akte të tjera nënligjore të cilat mund të mos jenë në përputhje me parashikimet e projektligjit.

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Monitorimi i zbatimit do të kryhet së pari nga vetë institucionet që ngarkohen me zbatimin e tij, si dhe nga të gjithë organizmat që ushtrojnë kontroll mbi institucionet publike, si Kontrolli i Lartë i Shtetit, inspektimi financiar, si dhe auditit i brendshëm.

Vlerësimi i zbatimit të projektligjit dhe arritjes së objektivave do të kryhet përmes raporteve vjetore që institucionet i paraqesin Kuvendit.

Treguesit për arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre janë:

1. Shmangia e vakuimit ligjor, brenda vitit 2023;
2. Krahasimi i pagës referuese bazë që del nga zbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese në raport me pagën që rezulton nga dispozita e re ligjore;
3. Raportet e KLSH-së, auditit të brendshëm etj.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin - një herë	79.9									
Kosto për buxhetin - në vazhdimësi										
Kosto për bizneset - një herë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kosto për bizneset - në vazhdimësi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kosto për grupet e tjera - një herë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kosto për grupet e tjera - në vazhdimësi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kosto në total	959	959	959	959	959	959	959	959	959	959
Kosto e zbritur= Kosto në total x Faktori zbritës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Përfitimet për buxhetin – një herë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Përfitimet për buxhetin – në vazhdimësi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Përfitimet për grupet e tjera – një herë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Përfitimet për grupet e tjera – në vazhdimësi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Përfitimet për biznesin – një herë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

Përfitimet për biznesin – në vazhdimësi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Përfitimet totale	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Përfitimi i zbritur = Përfitimi në total x faktori zbritës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Vlera prezente aktuale e përfitimit në total	-									
Vlera prezente aktuale e kostos në total	959									
Vlera Prezente Neto Aktuale (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	959									

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	0	0	0
Opsioni 2	959	959	959